



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/147
Datë: 15.06.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 146 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/147
Datë: 15.06.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 200,000.00 (dyqind mijë) euro, për mbulimin e shpenzimeve të sigurisë dhe nevojave tjera emergjente të NPQ "Aeroporti i Gjakovës" SH.A.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, nën kategoria ekonomike e Rezervës me kod 38010 dhe transferohen në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik kodi organizativ 213, nën-programi Njësia për Politika dhe Monitorimin e NP, me kod 23300, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nën kategoria subvencionet për etnitete publike me kod 21110.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/147
Datë: 15.06.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafi 8. të Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. protokoli 1468, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej 294,306.63 euro në buxhetin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, nga fondi për bashkëfinancim me IPA për zhvillim rajonal, sipas kodit 13134, në përputhje me 4 (katër) marrëveshjet e mirëkuptimit të nënshkruara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe kryetarët e komunave, për projekte kapitale.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAJA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/147
Datë: 15.06.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. protokoli 381/2, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i ndërtesave të përhershme të menaxhimit të integruar të kufirit IBM: Pika Kufitare Bërnjak, Zona Kadastrale Banjë, Komuna Zubin Potok për pjesët e parcelave nr. 1564-0 me sipërfaqe prej 1749m², nr. 1565 me sipërfaqe prej 172m², nr. 1568 me sipërfaqe shtesë prej 382m², nr.1576 me sipërfaqe shtesë prej 144m², nr. 1560 me sipërfaqe shtesë prej 5244m², nr. 1561 me sipërfaqe shtesë prej 1686m², nr. 1562 me sipërfaqe shtesë prej 1420m², nr. 1910 me sipërfaqe shtesë prej 4450m², nr. 1563 me sipërfaqe shtesë prej 782m², Pika Kufitare Merdar, Zona Kadastrale Merdar, Komuna Podujevë, për pjesët e parcelave nr. 47-0 me sipërfaqe prej 1992m², nr. 51-1 me sipërfaqe shtesë prej 1228m², nr. 51-2 me sipërfaqe shtesë prej 1101m², nr. 51-3 me sipërfaqe shtesë prej 271m², nr 53-2 me sipërfaqe shtesë prej 345m², nr. 50-0 me sipërfaqe shtesë prej 1543m², nr. 15-1, 15-2 me sipërfaqe shtesë prej 219m², nr. 13-0 me sipërfaqe shtesë prej 102m², nr. 49-0 me sipërfaqe shtesë prej 256m², nr. 48-0 me sipërfaqe shtesë prej 65m², nr. 545 me sipërfaqe shtesë prej 195m², nr. 16-0 me sipërfaqe shtesë prej 80m², nr. 544-2 me sipërfaqe shtesë prej 1147m², nr. 56-1 me sipërfaqe shtesë prej 1043m², nr. 55-3 me sipërfaqe shtesë prej 638m², nr. 55-4 me sipërfaqe shtesë prej 908m², dhe Pika kufitare Mutivodë, Zona kadastrale Dabishevc, Komuna Prishtinë, për pjesët e parcelave nr. 335-1 me sipërfaqe shtesë prej 328m², nr. 335-2 me sipërfaqe shtesë prej 109m², nr. 335-3 me sipërfaqe shtesë prej 244m², nr.335-4 me sipërfaqe shtesë prej 2416m², nr. 322-0 me sipërfaqe shtesë prej 1204m², nr. 316-1 me sipërfaqe shtesë prej 539m², nr. 1375-0 me sipërfaqe shtesë prej 1053m², nr. 1374-0 me sipërfaqe shtesë prej 289m², nr. 328-1, 328-2 me sipërfaqe shtesë prej 1111m², sipas tabelave pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokoli 5492/16 datë 06.12.2016.

3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara sipas pikës 1. të këtij vendimi.
4. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.
6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe 1 (një) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar me këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastralë në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryejë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/147

Datë: 15.06.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 9, 10 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës R6 Prishtinë - Hani i Elezit, Sektori C3, Zonat kadastrale: Paldenicë, Neqavc, Dimcë dhe Hani i Elezit, Komuna Hani i Elezit dhe Zonat Kadastrale: Kovaçec, Bob, Gajre dhe Gjurgjedell të Komunës së Kaçanikut, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela parqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/147
Datë: 15.06.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 9 të Ligjit nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përkatësisht Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, për kompensimin e shtesave dhe stimulim financiar për vitin 2017 për kryeprokurorë, prokurorë të krimeve të rënda dhe për të mitur, në shumë prej 185,077.92 euro.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi janë të planifikuara në ndarjet buxhetore të vitit 2017 në organizatën buxhetore Këshilli Prokurorial i Kosovës me kod 250, nën programi Prokurorët dhe Administrata me kod 33500, kategoria ekonomike e Pagave dhe Mëditjeve, nën kategoria shtesat dhe kompensimet tjera me kod 11155.
3. Obligohet Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë